

MBI DOMETHËNIEN HISTORIKE TË RIHAPJES SË SHËN SOFISË

Me emrin e Allahut, të Mëshirshmit, Mëshiruesit

1. Shën Sofia është ndërtuar si kishë rreth dyqind vjet para ardhjes në këtë botë të Profetit të Islamit, Muhammedit (paqja dhe begatia e Zotit qofshin mbi të), dhe zë një vend madhështor edhe në historinë e njerëzimit, edhe në historinë turko-islame.
2. Të dhënat historike që posedojmë, e konfirmojnë me konsensus faktin se ndërtuesit e saj të parë e kanë ngritur këtë faltore të lashtë me qëllimin që aty të adhurohet Zoti i vetëm, Krijuesi i gjithësisë nga hiçi. Ky qëllim sublim është përmbushur pa ndërprerje, që nga çlirimi i Stambollit më 1453 nga Sulltan Mehmet Fatihu sipas sihariqit të Profetit e deri në fillim të shekullit të kaluar.
3. Me Traktatin që shpalli menjëherë pas çlirimit të Stambollit, të gjithë jomuslimanët që jetonin në Stamboll Sulltan Mehmet Fatihu i la të lirë në besimin, adhurimet dhe jetesën e tyre, duke u garantuar çdo siguri për jetën dhe pasurinë, me në krye faltoret e tyre, me zotimin se “do t’ju mbrojmë siç mbrojmë veten tonë”. Por si përjashtim, nisur nga qëllimi sublim i përmendur më lart, Shën Sofinë e ktheu në xhami dhe ia besoi kombit tonë si vakëf me kusht që ta ruajë si një faltore të Islamit deri në Ditën e Fundit.
4. Ndryshe nga dëmet dhe shkatërrimet e mëdha që i janë bërë herëpashere nga vetë besimtarët e saj para çlirimit të Stambollit, kombi ynë këtë faltore të pashoqe gjithmonë e ka mbrojtur me përkushtim të madh, madje nuk ia ka ndryshuar as emrin. Me minaret e shtuara si simbole të teuhidit dhe me sexhdet që i janë bërë Zotit të Mëshirshëm e Mëshirues aty përgjatë shekujve, Shën Sofia është ruajtur si një faltore ku është jetësuar qëllimi sublim i ndërtuesve të saj.
5. Përtej një faltoreje ku adhurohet, me institucionet e dijes që u ndërtuan përreth saj për t’u shërbyer fushave të ndryshme si astronomia, jurisprudenca, matematika, teologjia etj., Shën Sofia deri në vitin 1934 për pesë shekuj me radhë shërbeu si një kompleks dijeje ku mësohej urtësia hyjnore, duke i dhënë hakun edhe emrit të saj.

6. Në vitin 1934 Shën Sofia fillimisht u mbyll për restaurim, pastaj me një vendim radikal u kthye në muze. Kjo gjendje që bie ndesh edhe me paprekshmërinë e tempujve, edhe me trashëgiminë historike, edhe me traditën tonë vakëfnore, që atëherë ka qenë një brengë për kombin tonë dhe zhgënjimi i shkaktuar nga ky akt që bërë burim i një shqetësimi gjithnjë e më të madh në shoqëri. Kurse diskutimi i hapjes së Shën Sofisë për adhurim si një çështje pavarësie e lirie, madje tutele politike, në rrethe të ndryshme herëpashere, gjithmonë ka përbërë një plagë që e ka lënduar çdo individ të kombit tonë.

7. Shën Sofia nuk është kthyer nga kishë në xhami, siç kanë shkruar mediat perëndimore, por është rikthyer në identitetin e saj të vërtetë pesë shekullor, në xhami, pasi që kthyer më parë në muze. Prandaj është tejet e gabuar që rihapja e Shën Sofisë për adhurim si një faltore e Islamit të trajtohet si pjesë e një retorike të papërmbajtur tensioni në përmasa globale dhe që kërkesa e drejtë dhe e çiltër në këtë drejtim të paraqitet si sinjal i një përplasjeje të mundshme mes feve dhe qytetërimeve. Kjo gjë i bëjnë të mendojnë pjesëtarët e një qytetërimi që përgjatë historisë nuk e ka pasur kurrë të vështirë t'u ofrojë hapësira lirie të gjitha feve.

8. Është emocionues gëzimi dhe entuziazmi që po përjeton një komb i tërë nga rihapja, pas një ndërprerjeje të hidhur tetëdhjetë e gjashtë vjeçare, e një faltoreje të privuar nga besimtarët. Uniteti që kanë treguar për Shën Sofinë kahjet, organizmat dhe shkollat e ndryshme politike, e kanë treguar edhe njëherë se sa të drejtë janë hapat e hedhur për ndreqjen e këtij gabimi historik.

9. Ashtu siç ka ndodhur në të gjitha faltoret tona përgjatë historisë, nuk ka dyshim se Shën Sofia do t'i ketë dyert të hapura për të gjithë, jo vetëm për besimtarët shpirtgjerë, por edhe për ata që shpresojnë të gjejnë një rrugë drejt Zotit të tyre nga kjo faltore. Mikpritësit e vizitorëve që do të vijnë në Shën Sofi për t'u ngritur shpirtërisht, në çdo rast e kanë treguar se janë të gatshëm ta bëjnë këtë, si bij të një qytetërimi të lashtë e të gjatë.

10. Për të gjitha këto arsye, rihapja e Shën Sofisë për adhurim meriton çdo lëvdatë. Me këtë rast duhet thënë se ky hap i Presidentit të Republikës së Turqisë Recep Tayyip Erdoğan, jo vetëm shpreh ndjenjat e grumbulluara të mbarë botës islame, por bart edhe potencialin për të ringjallur një respekt të thellë, një vetëbesim të fortë dhe një ndjenjë të fuqishme përkatësie.

INSTITUTI I MENDIMIT ISLAM

Për opinionin publik, me respekt

